



UNIVERSITETI I TIRANËS

SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr.15, datë 06.07.2017

“Për vendosjen e bustit të Mustafa Demiri në Kopshtin Botanik”

Mbështetur në Vendimin nr.5 datë 10.05.2017 të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, bazuar në nenin 38, pika 3 të ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucione të tjera të arsimit të lartë” dhe në nenin 19 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 06.07.2017,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e paraqitur nga Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës për vendosjen e bustit të **Profesor Mustafa Demiri** në Kopshtin Botanik, pjesë e Qendrës Kërkimore të Florës dhe Faunës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të UT, me motivacionin: “Për një kontribut të shquar në krijimin dhe zhvillimin e Kopshtit Botanik”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR.MYNYR KONI